**Titulli i lëndës: METODA KËRKIMI NË SHKENCAT SOCIALE**

| **Informatat themelore për lëndën** | |
|---|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Filologjisë |
| Titulli i lëndës: | Metoda Kërkimi në Shkencat Sociale |
| M | Bachelor |
| Statusi i lëndës: | Z |
| Viti i studimeve: | 2024-2025 |
| Numri i orëve në javë: | 2+2 |
| Kreditë ECTS: | 5 ECTS |
| Koha / Vendi: | E martë, 10:00, Salla 101 |
| Mësimdhënësi: | Prof. Asoc. Dr. Arben Fetoshi |
| Të dhënat kontaktuese: | arben.fetoshi@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës: | Lënda "Metoda Kërkimi në Shkencat Sociale" ofron përmbajtje të vlefshme për përgatitje studentëve lidhur me punën hulumtuese shkencore. Përmbajtja është përcaktuar në baz bibliografisë së autorëve shqiptarë dhe të huaj, me një strukturim të përshtatshëm për ni Bachelor. Si njëra nga lëndët më të rëndësishme në programin e Gazetarisë, ajo do t'i aft studentët për dallimin ndërmjet hulumtimit shkencor dhe atij profesional (mediatik), për projektimin e një hulumtimi, përcaktimin e metodave të nevojshme dhe procesin e realiz të tij. Duke shqyrtuar specifikat e fushës së mediave dhe komunikimit, konceptet, teknika dhe metodat e hulumtimit shkencor, studentët do të pajisen me njohuri solide për punë t pavarur kërkimore, jo vetëm përgjatë studimeve themelore. |
| Qëllimet e lëndës: | Lënda ka për qëllim t'i pajisë studentët me njohuritë e nevojshme për procesin e hulumtimit shkencor, dizajnimin, fazat dhe metodat më efikase në fushën e komunikimit. Kombinimi adekuat i ligjëratave dhe ushtrimeve do t'u ofrojë studentëve një pasqyrë sa më të qartë të mundësive dhe kufizimeve që përfaqësojnë metoda të caktuara për hulumtimet në gazetari. |
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | Pas përfundimit të kursit, studentët do të jenë në gjendje të: |
| | - Identifikojnë / shpjegojnë konceptet, parimet kryesore dhe llojet e hulumtimeve hkencore; |

| | |
|---|---|
| | - Njohin dhe aplikojnë metodat adekuate të hulumtimit shkencor; |
| | - Analizojnë, vlerësojnë dhe krahasojnë të dhënat primare dhe sekondare në punën hulumtuese shkencore. |

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---|---|---|---|
| Ligjëratat | 2 | 15 | 30 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtrime | 2 | 15 | 30 |
| Punë praktike | | | |
| Përgatitje për test intermediar | 2 | 1 | 2 |
| Konsultime me mësimdhënësin | 30 min. | 15 | 7.5 |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi i seminarit | 10 | 2 | 20 |
| Detyrë shtëpie | 1 | 15 | 15 |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | 1 | 15 | 15 |
| Përgatitja për provimin final | 4 | 1 | 4 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | 1 | 2 | 2 |
| Projekti hulumtues, prezantimi, etj. | 1 | 1 | 1 |
| Total | | | **126.5** |

| | |
|---|---|
| Metodat e mësimdhënies: | Përmbajtja e lëndës do të zhvillohet me ligjërata interaktive, video prezantime dhe ushtrime praktike. |
| Metodat e vlerësimit: | **Vlerësimi i studentëve do të bëhet në bazë të formulës së mëposhtme:**<br>1. Pjesëmarrja aktive 10 %<br>2. Ushtrime (detyrat) 20 %<br>3. Projekti hulumtues 30 %<br>4. Provimit përfundimtar 40 %<br>TOTALI: 100 %<br>• Pjesëmarrja nuk nënkupton vetëm vijueshmërinë, studentët do të vlerësohen në bazë të cilësisë së komenteve, vëmendjes, qëndrimit dhe sjelljes në klasë. |

| | |
|---|---|
| Literatura primare: | 1. Bob Matthews & Liz Ross, Metodat e Hulumtimit- *Udhëzue spraktik për shkencat socia dhe humane*, botimi ne shqip, Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Tiranë, 2010<br>2. Anders Hansen & David Manchin, Media & Communication Research Methods, Palgrav Macmillan, 2013 |
| Literatura shtesë: | 1. Anol Bhattacherjee, Social Science Research: Principles, Methods and Practices, Univer of South Florida, 2012, https://scholarcommons.usf.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1002&context=oa_textb<br>2. James A. Anderson, Media Research Methods, Understanding Metric and Interpretive Approaches, University of Utah, SAGE Publications, 2012 |

| **Hartimi i planit mësimor** | |
|---|---|
| Java | Titulli i ligjëratës |
| Java 1: | • Hyrje në Metodologjinë e Shkencave Sociale<br>*(Historia e Mendimit Shkencor)* |
| Java 2: | • Shkenca dhe Studimi<br>*(Pse bëhet kërkimi shkencor?)* |
| Java 3: | • Qasjet teorike për Kërkimin Shkencor<br>*(Metoda Shkencore)* |
| Java 4: | • Planifikimi i Projektit Hulumtues<br>*(Pyetjet Kërkimore, Shqyrtimi i literaturës)* |
| Java 5: | • Planifikimi i Projektit Hulumtues<br>*(Hipoteza, Variablat)* |
| Java 6: | • Hulumtimi Empirik<br>*(Intervista e strukturuar dhe e pastrukturuar)* |
| Java 7: | • Prezantim i Detyrave Projektuese |
| Java 8: | • Hulumtimi Empirik<br>(*Anketa – Hartimi dhe administrimi i Pyetësorëve)* |
| Java 9: | • Mbledhja e të Dhënave<br>*(Kërkimi Vëzhgues, Eksperimental, i Rastit dhe Interpretues)* |
| Java 10: | • Analiza Kuantitative |

| | |
|---|---|
| Java 11: | • Analiza Kualitative |
| Java 12: | • Përgatitja e punimit<br>(Interpretimi i të dhënave dhe raportimi i përfundimeve) |
| Java 13: | • Kërkimi Shkencor në epokën digjitale<br>(Përparësitë dhe Ssfidat) |
| Java 14: | • Etika dhe integriteti në Kërkimin Shkencor |
| Java 15: | • Diskutim përmbledhës për lëndën |

**Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën në heshtje për të marrë shënime; aktivitete të tjera, siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit. Nga të gjithë pritet të jenë të sjellshëm dhe të respektueshëm ndaj të tjerëve gjatë diskutimeve, dhe nuk bënë të përdorët gjuhë e pahijshme. Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe janë pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit.